MALISHEVA

Historiku i Komunës

Llapushë është nocioni tjetër me të cilin është i njohur territori I komunës së Malishevës. Lashtësia e Malishevës si vendbanim dëshmohet edhe me prezencën e tumës ilire në vetë qendrën e Malishevës, dëshmi kjo që jep të kuptohet se Malisheva ka qenë vendbanim i hershëm ilir bashkë me vendbanimet tjera në komunë, që janë shtrirë përgjatë lumit Mirusha. Historikisht, qendra administrative politike ka ndryshuar edhe në aspektin e emërtimit edhe në aspektin e selisë. Në kohën e pushtimit turk të këtyre territoreve, përmendet Bajraku I Astrazubit, që për nga shtrirja shkonte deri në vijën hekurudhore prej Murës në veri e deri në Mrasor në perëndim. Më vonë e hasim emërtimin Rrethi i Rahovecit, që kapte të njëjtin territor.
Pas Luftës së Dytë Botërore, pushteti lokal fillimisht u organizua në fshatin Bajë dhe në fshatin Kijevë, për t.u transferuar pastaj më 1960 në Malishevë. Në këtë mënyrë Malisheva për herë të parë bëhet qendër administrative-politike. Më 1965 komuna e Malishevës shpërbëhet nga pushteti I atëhershëm jugosllav. Për herë të dytë komuna e Malishevës u formua si qendër komunale në vitin 1986, për të vazhduar deri në vitin 1991 kur pushteti serb e shpërbëri përsëri. Pas luftës, me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45, Malisheva u formua prapë si njësi e pavarur komunale, .de jure. e barabartë me të tjera komuna në vend.

Pozita Gjeografike

Komuna e Malishevës ka një sipërfaqe prej 306.3 km2. Ajo kufizohet: në veri me komunën e Klinës dhe të Drenasit, në lindje me komunën e Lipjanit dhe të Therandës, në jug me komunën e Therandës dhe të Rahovecit, dhe në perëndim me komunën e Rahovecit dhe të Klinës. Qendra komunale e Malishevës, si njësi administrative territoriale, përbëhet nga 39 njësi kadastrale dhe 44 vendbanime1, përfshirë këtu edhe vetë qendrën. Komuna e Malishevës shtrihet në anën perëndimore të Kosovës. Meqenëse ka largësi përafërsisht të njëjtë nga të gjitha qendrat tjera regjionale, mund të thuhet se ajo shtrihet në pjesën qendrore të saj.
Bazuar në këtë fakt, banorët e saj nuk gabojnë që e thërrasin qytezën e vetë .Zemra e Kosovës.. Qendra Regjionale për Malishevë është Prizreni, me një distancë prej 44 km. Largësia nga kryeqendra e Kosovës-Prishtina është 49 km. Pozita në qendër të Kosovës dhe konfiguracioni i përshtatshëm i terrenit, komunës së Malishevës i mundëson të ketë lidhje komunikimi të mira me tërë vendin. Territori i komunës është kryesisht kodrinor-malor. Format më të shpeshta të hasura në relievin e saj janë hurdhat dhe shpellat. Atë e përshkon pellgu i lumit Mirusha, me toka të rrafshëta e pjellore në të dy brigjet e saj. Komuna rrethohet edhe me masivin malor të Drenicës, me pikën më të lartë mbidetare të saj prej 1,057 m tek Maja e Kosmaqit dhe 1,006 m tek maja e Koznikut. Në territorin e komunës së Malishevës dominon klima e mesme kontinentale, që karakterizohet me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë. Temperaturat maksimale arrihen gjatë verës, mesatarisht 24.6°C, ndërkaq ato minimale shfaqen në janar, në vlera mesatare 10°C. Të reshurat atmosferike sillen prej 511-1108 mm në vit.

Popullsia

Në mungesë të të dhënave më të reja statistikore të regjistrimit të popullsisë, shënimet e prezantuara në vijim janë bazuar në të dhënat statistikore të para vitit 1999, si dhe në përllogaritjet interne të komunës pas vitit 1999 (Drejtoria për Shërbime Publike). Sipas këtyre të dhënave, komuna e Malishevës ka mbi 65,000 banorë. Që nga regjistrimi i vitit 1971 deri më sot, vlerësohet se popullsia e komunës së Malishevës është rritur për 31,320 banorë ose për 1,010 banorë në vit. Numri i përgjithshëm i familjeve është 8,450, me numër mesatar të anëtarëve për familje 7,7. Struktura gjinore e popullsisë është 55% meshkuj dhe 45 % femra. Përderisa struktura nacionale është 99.9% shqiptarë dhe 0.1% romë. Numri i popullsisë në komunë ka tendencë të rritjes.

Zhvillimi Ekonomik

Malisheva në përgjithësi ka shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik. Ishte dhe vazhdon të jetë komuna më e pazhvilluar në Kosovë. Bujqësia është njëra nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të komunës si dhe e gjenerimit të të ardhurave për banorët e komunës. Komuna e Malishevës ka burime të konsiderueshme të pasurive natyrore.
Sektori privat - Në komunën e Malishevës zhvillojnë aktivitet afërsisht 820 biznese private, me rreth 1,200 punëtorë të punësuar, nga të cilët 150 janë femra. Shumica (90%) prej këtyre bizneseve janë ndërmarrje të vogla, me numër të të punësuarve prej 1-9 punëtorë. Veprimtaria e tyre është kryesisht tregtare (afro 46%), prodhuese (18%), transportuese (14 %), zejtare (10%), hoteliere (5%), shërbyese (2.2%) dhe të tjera të ndryshme (4%).
Procesi i Privatizimit – Ndërmarrjet shoqërore dhe publike në komunë menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Ato shoqërore i nënshtrohen procesit të privatizimit apo falimentimit, varësisht nga gjendja e ndërmarrjes. Shtyllë udhëheqëse në ekonominë locale ishte ndërmarrja shoqërore NPB .Mirusha., e cila kishte të punësuar 700 punëtorë të rregullt dhe po aq sezonal, si dhe sipërfaqe në kultivim mbi 3,000 ha (hardhi rrushi, grurë, kolëz, luledielli, vishnje).Tani kjo ndërmarrje është privatizuar.
Prioritetet e Komunës . vazhdimi i iniciativave të qeverisë lokale në përkrahje të bizneseve gjatë viteve 2003/2005, dhe më tej, janë: Ndërtimi i qendrës tregtare në Malishevë, Caktimi i dy zonave për ngritjen e objekteve tregtare, me financim të vetë biznesmenëve (njëra është në fazën e implementimit), Caktimin e zonës industriale, në zonën kadastrale të Mirushës, në një sipërfaqe prej 31,30 ha, e përkufizuar me infrastrukturë, mjaft të favorshme për investime. Ndërsa në aspektin ligjor, është aprovuar Rregullorja Nr.01/879, dt. 30.10.2003, për leje komunale të punës, për veprimtaritë afariste. Kurse projektet kapitale zhvillimore investuese për të ardhmen (në lëmin e ekonomisë, janë): Rregulli i infrastrukturës në zonën e biznesit; Inkubatori i biznesit; Rritja e fondit të pemëtarisë; Rritja e fondit të vreshtarisë; Ndërtimi i serave për prodhimin e perimeve; Ngritja e stallave; Rritja e fondit blegtoral; Ngritja e qumështores në Malishevë; Ngritja e 10 mini fermave të kërmijve; Pyllëzimi i 40 ha me druajë halor; Ngritja e 4 fermave për prodhimin e vezëve; Penda akumuluese për qëllime ujitje në lumen Mirusha, lokacioni Mirushë; Penda akumuluese për qëllime ujitje, në lokacionin Gurbardh-Turjakë dhe Ngritja e kapacitetit teknologjik për tharjen e pemëve.

Turizmi

Komuna e Malishevës, edhe pse është komuna më e pazhvilluar e vendit, ka potenciale natyrore për të zhvilluar një degë të veçantë të ekonomisë - turizmin.
Disa nga pikat ku mund të orientohet zhvillimi i turizmit në komunë janë: Hapësira përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha, e cila, përkundër infrastructures së pazhvilluar përcjellëse, ka shumë visitor ë të vendit dhe nga jashtë. Relievi I rrjedhjes së lumit, me ujëvarat unike që krijon, është një xhevahir i vërtetë turistik. Shpella e flladit në fshatin Panorc, e cila gjendet në afërsi të lumit Mirusha, është tjetër xhevahir turistik i komunës. Aktualisht vetëm 945 m gjatësi të kësaj shpelle janë hulumtuar Stalaktitet dhe stalagmitet e saj, me bukurinë që kanë, mahnitin vizitorët e rastit, të cilët gjithnjë e më shumë po shënojnë rritje. Në fshatin Ngucat ekziston edhe një shpell ë tjetër e pa hulumtuar ende, për të cilën mendohet se do të jetë atraksion tjetër I madh për turistët.
Në fshatin Bajë gjendet burimi i ujit termal me kapacitet 250-300 l/sec. Mbi këtë burim të ujit është ngritur pishina me sipërfaqe 2000 m2, e cila çdo sezon vere është në shfrytëzim për freskim dhe organizim të garave të notit nga të interesuarit. Pishina ka vizitorë të shumtë, jo vetëm të komunës por edhe nga mbarë vendi. Uji i kësaj pishine ofron edhe mundësi shërimi nga një numër i caktuar i sëmundjeve të lëkurës. Temperatura konstante e ujit gjatë tërë vitit është 22ºC. Mendohet që në të ardhmen e afërt ky vend të shndërrohet në vend turistik për rekreacion, sport dhe rehabilitim. Malet e Berishës janë atraksion tjetër turistik, jo vetëm për banorët e komunës. Me llojllojshmërinë e florës dhe faunës së tyre, tërheqin shumë vizitorë për piknik malor.

Vende interesante për t.u vizituar

Pishina e Bajës në fshatin Bajë; Shpella e Flladit, në fshatin Panorc; Ujëvarat e Mirushës, në fshatin Llapqevë; Ura e Arabaxhive, në fshatin Bubël; Malet e Berishës, në fshatin Berishë; Varrezat e Dëshmorëve, në Malishevë dhe në fshatin Kleçkë, etj.

Shërbimet Publike - Administrative

Arsimi - Në komunën e Malishevës, në bazë të riorganizimit të procesit edukativo-arsimor nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), si dhe mbështetur në Ligjin e Arsimit, procesi arsimor realizohet në këto nivele: parafillor, fillor, i mesëm i ulët, i mesëm i lartë dhe arsim special. Të gjitha këto janë të organizuara në kuadër të arsimit publik.
Në komunë nuk ekziston asnjë shkollë private. Ekzistojnë njëzetegjashtë shkolla fillore me katërmbëdhjetë paralele të ndara, dy shkolla të mesme dhe dy paralele për mësim special. Në bazë të Ligjit të ri për Arsimin, të gjitha shkollat fillore janë shkolla nëntëvjeçare.
Numri i nxënësve në institucionet parashkollore në komunën e Malishevës është 1.511. Ndërsa totali i nxënësve në shkollat fillore në këtë komunë është 13.454. Kurse në shkollat e mesme vijojnë mësimet 2.759 nxënës. Numri i mësuesve, arsimtarëve dhe profesorëve në këtë komunë është 1.048.
Kultura - Në bazë të të dhënave demografike për komunën, rreth 25% e popullatës nga numri i përgjithshëm i saj i takon grupmosh ës prej 15-25 vjeç. Në komunë nuk ekziston asnjë qendër kulturore, shtëpi kulture, qendër rinore apo edhe sportive, ku rinia do të organizonte aktivitete të

ndryshme shoqërore. Si qendër rinore aktualisht shërben një objekt i montuar për këtë qëllim, dhuratë nga OSCE. Malisheva me dyzet e tri (43) vendbanime, përfshirë këtu edhe qendrën komunale, nuk ka shtëpi të kulturës, bibliotekë, muze, teatër e as kinema.
Shërbimet publike komunale - Në komunën e Malishevës funksionojnë shtatë ndërmarrje publike të cilat merren me menaxhimin e shërbimeve publike nga fusha të ndryshme, ato janë: NK .Lumi. e cila merret me menaxhimin e mbeturinave; Nj. Hidroregjioni Jugor .Syri i Kaltër. e cila merret me menaxhimi I ujërave; Njësia e KEK-ut e cila menaxhon energjinë elektrike; Njësia e PTK-së e cila ofron shërbimet e Postë Telekomunikacionit; Stacioni i autobusëve i cili organizon transportin e udhëtarëve; Ekonomia e pyjeve e cila merret me menaxhimin e pyjeve; Stacioni i veterinarisë që menaxhon me shërbimet veterinare.

Infrastruktura

Rrugët - Në komunën e Malishevës ekzistojnë 150 km rrugë. Gjendja e rrugëve nuk është e kënaqshme, me gjithë intervenimet që janë bërë kohë pas kohe, në kuptimin e rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së tyre. Në komunën e Malishevës ekzistojnë edhe 33 ura. Poashtu në këtë komunë janë të asfaltuara 96 km rrugë (64%).
Uji - Në komunën e Malishevës, për furnizim me ujë dhe kanalizim përkujdeset ndërmarrja .Syri i Kaltër.. Kjo ndërmarrje është formuar në vitin 2003 dhe është njësi operative e Ndërmarrjes Regjionale për Ujë .Hidroregjioni jugor., me seli në Prizren. Furnizimi me ujë të pijshëm në komunë është pjesërisht i zgjidhur dhe atë vetëm për një numër të caktuar lokalitetesh. Në territorin e komunës ka 96.5 km, në 18 fshatra (41% të fshatrave). Komuna (qendra komunale) bashkë me 4 fshatra, furnizohen nga i njëjti sistem i ujësjellësit (ujësjellësi publik), nga burimi i Bajës me sistem të pompimit. Ndërsa ekzistojnë edhe 10 ujësjellës tjerë individual që furnizojnë fshatrat me ujë nga burimet e afërta, prej të cilëve 6 janë gravitor (rënie e lirë), dhe 4 tjerë funksionojnë me sistem të pompimit.
Shoqëria civile - Në komunën e Malishevës veprojnë rreth 21 shoqata që janë pjesë e shoqërisë civile, ato janë: CIMIC . Gjerman e cila ofron Këshillime dhe ndihma momentale humanitare popullatës së komunës; MLIF-4 (AER); . QMFG . e cila ofron Këshilla, rehabilitime, trajnime, kurse për fëmijë dhe gra; .Femrat e Llapushës. ; Shoqata e të Verbërve .; .Nëna Terezë . e cila merret me ofrimin e ndihmave humanitare popullatës; . Kryqi i Kuqë.; . Handikos e cila ofron Ndihmë , këshilla, trajnime, kurse (personave me hendikep); .Invalidët e Luftës. e cila ofron ndihmë për invalidët e luftës; . Miqtë e TMK-së. E cila ka ndihmuar ngritjen profesionale të TMK-së; Shoqata e Bletarëve .Mëma. e cila ofron këshilla dhe trajnime bletarëve; Shoqata e Veteranëve të Luftës; Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Luftës; .Agrollapusha.; Qendra Rinore; Vizioni I ardhmërisë; KMLDNJ;Avancimi i të Drejtave, etj.